

SPASTRIMI ETNIK DHE FETAR I SHQIPTARËVE, 1878-1999 (KOSOVA NË VEÇANTI)

Midis shqiptarëve dhe sllavëve qëndrojnë shekuj gjakmarrje dhe urrejtje. Ne i kemi parë sllavët gjithmonë si hajdutë dhe grabitës, ndërkohë që ata e kanë parë shqiptarin si një njeri të papërshtatshëm për bashkëpunim, ndonëse ndonjëherë edhe i mundur, prapëseprapë si njeri që nuk e pranon humbjen. Sllavët endacakë dhe pa atdhe na kanë parë gjithmonë si pengesën më të madhe në përpjekjet e tyre të pareshtura për shtrirje hapësinore. Mirëpo, për shekuj me radhë, duke pasur përparësinë e të qenurit për afërsisht më të aftë në letërsi, ata vazhdimisht e kanë paraqitur shqiptarin si kaçak dhe kërcënues për fshatrat e tyre. Për hir të fakteve historike, duhet thënë se çizmet janë veshur mbrapsht në këtë rast. Duke lënë mënjanë faktin që si sllavët, ashtu edhe shqiptarët në raste të veçanta mund të kenë qenë kaçakë, fiset shqiptare për shekuj me radhë kanë jetuar paqësisht përkrah njëri-tjetrit, derisa turmat sllave kapërcyen Danubin dhe vërshuan drejt jug-perëndimit duke i shtyrë banorët e vjetër nga fushat në drejtim të maleve. Përgjatë vargmaleve të pakalueshme të anës perëndimore të Gadishullit Ilirik, përballë detit Adriatik, të mbijetuarit e racës së lashtë të Ilirisë, Epirit, Maqedonisë dhe Trakës për shekuj me radhë i kanë bërë qëndresë çdolloj mësymjeje të keltëve, gothëve, serbëve, bullgarëve dhe turqve.

Ashtu si malazezët, të cilët nuk i lëshuan pjesët veriore të maleve të tyre, edhe ne shqiptarët, herë pas here jemi mundur, por asnjëherë nuk jemi dorëzuar. Ne kemi parë fshatra të djegura dhe familjet tona të masakruara, por në të vërtetë kurrë nuk jemi pushtuar. I vetmi ndryshim qëndron në faktin se ndërkohë që vazhduam qëndresën tonë brez pas brezi përpara se sllavët dhe malazezët të kapërcenin Danubin në drejtim të jugut, asnjëherë nuk patëm fat. Apo e thënë ndryshe, ndoshta na mungoi zgjuarsia për të gjetur një përfaqësues çudibërës të letrave. Edhe vetë lordi Bajron na anashkaloi ne për grekët, megjithëse e pranoi që:

“shqiptari i egër me fustanellë deri në gju” asnjëherë nuk ia ktheu shpinën armikut dhe kurrë nuk e preu në besë mikun. “Ka të ngjarë që çlirimi i Greqisë s’do të kishte ndodhur kurrë po të mos kishin qënë luftëtarët shqiptarë, të cilët bënë pjesën më të madhe të luftës. Admirali Mjauli, Boçari dhe Bullgari dhe shumë heronj të tjerë të Revolucionit Grek ishin shqiptarë nga raca shqiptare”.⁽¹⁾

Ndërkohë që grekët e sotëm jetuan gati dy shekuj me letërsinë e lavdishme të Homerit të lashtë, ne shqiptarët, ashtu si paraardhësit tanë, të cilët jetuan përpara Agamemnonit, u lamë në harresë.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për serbët, të cilët përmes përrallave dhe miteve të periudhës mesjetare ndërtaun një përfytyrim shumë më mbresëlënës sesa vërtetësia jetësore, në të mirën e qëllimeve të tyre keqdashëse. Ndërkohë që grekët shfrytëzuan lashtësinë, serbët në mungesë të rrënjëve historike shfrytëzuan mesjetën, pikërisht periudhën e ngritjes së Perandorisë Osmane dhe rënien e Perandorisë Bizantine.

Sipas kronikave të kohës, në prill të vitit 1453, filloi rrethimi i Kostandinopojës nga sulltan Mehmeti II. Përpara së të fillonte beteja, Mehmeti II i premtoi Kostandinut se nëse dorëzohej do ia falte jetën dhe se do ta njihte si sundimtar të Mistrës. Përgjigjja e tij, e ruajtur nga G. Sphrantzes, ishte: *“Dorëzimi i qytetit në duart tuaja është përtej së drejtës time apo të kujtdo tjetër që jeton në të, dhe ne të gjithë pasi morëm një vendim të përbashkët, do pranojmë vdekjen me dëshirë, pa kursyer as jetët tona”*. Kostandini u pa për herë të fundit duke zhveshur petkun perandorak dhe duke iu bashkuar të tjerëve për mbrojtjen e qytetit me shpatë në dorë. Ai u vra në muret e qytetit, pasi turqit kishin çarë muret mbrojtëse të tij, më 29 maj 1453.⁽²⁾

Rënia e Kostandinut, perandorit të fundit të Bizantit, në Kostandinopojë, ishte shumë më dramatike sesa rënia e car Llazarit në Fushë-Kosovë. Madje, edhe vdekja e vetë Millosh Kopilit(q), kalorësit shqiptar, pasi vrau sulltan Muratin është

¹ Wadham Peacock - Albania - The founding state of Europe, New York, D. Appleton & Company 1914, MCM-XIV. Faqe 178-179.

² Encyclopedia Britannica <https://www.britannica.com/biography/Constantine-XI-Palaeologus>

shumë më dramatike.⁽³⁾ Në fund të fundit, car Llazari u zu rob, u burgos dhe pastaj iu pre koka.⁽⁴⁾ Mirëpo vajtimi mbarëkombëtar i serbëve për ditën e zezë të Kosovës, duket sikur e pati mbërthyer prej shekujsh imagjinatën e Europës.

Bajroni, Finli dhe qindra të tjerë bënë më të mirën e mundshme për të bindur Europën se grekët e sotëm janë pasardhësit e helenëve të lashtë. Fatkeqësisht, asnjëri prej tyre nuk na dha ne shqiptarëve atë që meritojmë në këtë drejtim. Pastaj moda ndryshoi dhe sllavët dolën në pah. Zoti Gladston, lordi Tenyson me sonetën për malazetët, zonjusha Irby e Sarajevës dhe një tufë shkrimtarësh të tjerë nxituan të lavdëronin pa kursim Serbinë dhe jo më pak edhe Bullgarinë e cila, paçka se më pak simpatike, megjithatë është e sllavizuar. Krenar dhe fjalëpak në vargmalet tona, pa një betejë të dokumentuar, qoftë ajo dhe e humbur për t'ju mburrur Perëndimit, nuk i kërkuam asgjë Europës dhe aq më tepër, Europa nuk na dha asgjë asnjëherë ne shqiptarëve. Koha tregoi se grekët nuk arritën të përlligjin lavdinë që pritej prej tyre dhe si rrjedhojë as ata nuk janë tashmë, më të spikaturit. Dihet që sllavët u vunë në qendër të vëmendjes gjatë periudhës së mbretëreshës britanike Viktoria dhe që nga viti 1880 u bënë fëmijët e llastuar të Europës së harlisur.

Si pasojë e kësaj harlisjeje, u la në harresë fakti se shqiptarët përfaqësojnë pronarët e vërtetë të Gadishullit Ilirik dhe se serbët kapërcyen Danubin dhe u dyndën drejt jugut rreth viteve 550 të e.s, të ndjekur nga bullgarët rreth viteve 679 të e.s. Pra, ne kishim shijuar për më shumë se njëmbëdhjetë shekuj zotërimin e tokës, duke i dhënë jetë qoftë me luftra ndërfishnore, apo beteja nën udhëheqjen e mbretërve të lashtë maqedonas, pa lënë mënjanë edhe qëndresën ndaj Romës. Për çdo copë toke që serbët mund të pretendojnë se u takon me të drejtën e pushtuesit të një perandorie kalimtare, ne shqiptarët mund ta kundërshtojmë dhe të kërkojmë të jemi pronarët e vërtetë të këtij dheu, që nga kohët kur qoftë historia, qoftë sllavët nuk ishin të njohur në Ballkan.

Bashkë me dyndjet sllave filloi dhe urrejtja e pavdekshme midis shqiptarëve dhe serbëve, e cila është më e hidhur sot sesa

³ Anna di Lellio (tr. Robert Elsie).

⁴ Encyclopedia Britannica <https://www.britannica.com/event/Battle-of-Kosovo-1389-Balkans>.

kurrë më parë. Ne, me plot të drejtë, vazhdojmë t'i shohim serbët si pushtues dhe shkatërrues të shtëpive dhe vendit tonë. Kjo deri diku i jep përgjigje edhe pyetjes se përse shqiptarët kanë qenë më miqësorë me turkun mysliman sesa me sllavin e krishterë. Sjellja e ashpër e turqve nuk ishte asgjë në krahasim me krimet çnjerëzore të sllavëve. As beteja e Fushë – Kosovës më 1389, (kundër armikut të përbashkët), në të cilën shumë shqiptarë të udhëhequr nga prijës Balsha luftuan bashkë me ushtrinë e car Lllazarit, nuk ka mjaftuar sadopak në përmirësimin e marrëdhënieve, qoftë për një periudhë shumë të shkurtër kohore. Këto marrëdhënie të përkeqësuar, gjithmonë janë parë në këndvështrimin kombëtar deri më 1878, në çastin kur Bismarku nuk mori parasysh faktet të cilat nuk i shkonin atij përshtat dhe ashpërsisht këmbënguli në Kongresin e Berlinit: *“Nuk ka komb shqiptar”*.⁽⁵⁾

Ndërkohë që Bismarku fliste, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, provoi se sa gabim ishte ai. Sado i rëndë të ketë qenë gabimi, tashmë shigjeta kishte dalë nga harku. Serbët, të përkrahur fuqimisht nga rusët, e shfrytëzuan deklaratën dhe ndërmorën fushata shfarosëse ndaj “myslimanëve”, që në të vërtetë ishin ndaj shqiptarëve. Urrejtjes kombëtare iu shtua edhe ajo fetare. Në emër të mbrojtjes së vlerave dhe qytetërimit europian, ata po shfarosnin kombin më të vjetër të Europës. Gjatë kësaj periudhe, Serbia filloi propagandën serbomadhe për të bindur kancelaritë europiane se nuk ka komb shqiptar, por vetëm disa fise nomade, se ata nuk kanë gjuhë të tyre përveç një përzierje fjalësh si gjuha e ciganëve, se janë primitivë dhe të paaftë të ndërtojnë shtet etj. Serbia, në vijimësi ndërmori hapa konkretë, duke filluar shfarosjen në masë të shqiptarëve, sidomos gjatë periudhës së luftës ruso-turke. Vetëm në krahinën e Nishit, gjatë kësaj periudhe, u shkatërruan 600 fshatra shqiptare dhe rreth 300000 shqiptarë u shpërngulën nën tmerrin e bajonetave.⁽⁶⁾

Serbët dhe shqiptarët e shpallën pavarësinë ndaj Perandorisë Osmane pothuajse në të njëjtën kohë. Kjo pikëpamje pranohet nëse e shohim Lidhjen Shqiptare të Prizrenit si çastin e shpalljes së pavarësisë së shqiptarëve nga Perandoria Osmane. Mirëpo,

⁵ Wadham Peacock - Albania - The founding state of Europe, New York, D. Appleton & Company 1914, MCM-XIV fq. 176.

⁶ Shaban Braha - Gjenocidi Serb në Kosovë. AIITC, Tiranë 1999, faqe 38.

Kongresi i Berlinit ia njohu pavarësinë Serbisë, ndërsa ideja e pavarësisë së shqiptarëve nuk u përkrah nga Europa. Për këtë arsye, si dhe falë kundërshtisë së ashpër të Perandorisë Osmane për çfarëdolloj pavarësie, shqiptarëve iu desh të luftonin deri më 1913-n për ta detyruar Europën të njohë një shtet të cinguar shqiptar. Shkaktarë të vërtetë për këtë çështje ishin fjalët e Bismarkut dhe përkatësia fetare e shumicës së shqiptarëve. Kjo njohje tepër e vonuar, tragjikisht përkon me një valë tjetër dëbimi ndaj shqiptarëve. I vetmi ndryshim kësaj radhe ishte fakti se Serbia nuk ishte vetëm në fushatën e saj shfarosëse antishqiptare. Asaj tashmë i bashkohen Bullgaria dhe Greqia. Kozakët u zëvendësuan me kaçakët dhe ndonëse jo aq të organizuar sa në kohën e Luftës Ruso-Turke, kur erdhi puna te shqiptarët nuk i kursyen masakrat çnjerëzore. Si rrjedhojë, shfarosja e shqiptarëve u shtri jo vetëm në Kosovë, por tashmë edhe në Iliridë dhe sidomos në Çamëri. Vetëm në krahinën midis Kërçovës dhe Krushevës gjatë Luftës Ballkanike (1912-1914), u bastisën 19 nga 36 fshatra shqiptaro-myslimane nga banda kaçakësh të organizuara zyrtarisht nga bullgarët...⁽⁷⁾

E njëjta gjë po ndodhte edhe me shqiptarët e Çamërisë. Në vitin 1914, grekët shpallën të ashtuquajturën Republika e Epirit, e cila nuk ishte gjë tjetër veçse një përpjekje e mirëorganizuar për shfarosjen e shqiptarëve në Çamëri. Shfarosja e shqiptarëve arriti kulmin gjatë shkëmbimit të popullsisë midis Greqisë dhe Turqisë gjatë viteve 1923-1929. Sipas të gjitha shkresave dhe dëshmive të autoriteteve ndërkombëtare, nga 500 mijë myslimanë të shpërngulur nga Greqia drejt Turqisë, shumica dërrmuese e tyre ishin shqiptarë çamë. Grekët ashtu si dhe serbët e arsyetuan shfarosjen e shqiptarëve si përpjekje për të mbrojtur vlerat europiane. Theksi u vu te përkatësia fetare, gjë që i ndihmonte grekët në qëllimet e tyre për ndërtimin e një shteti sa më të gjerë dhe etnikisht të pastër. Duke u nisur nga ky “vetëflijm” i grekëve në emër të vlerave europiane, natyrshëm lind pyetja: A kanë qenë grekët përgjatë historisë së tyre kaq të dashur me Europën?! Përgjigjen më së miri na e japin kronikat e kohës.

Në mesin e shekullit XIV, mosmarrëveshjet midis Kantacuzenus dhe Paleologit në lidhje me fronin e Perandorisë

⁷ Justin Mc Carthy – Vdekje dhe dëbim, F. 183.

Bizantine, sollën vendosjen për herë të parë në histori, të osmanëve në Gadishullin Ilirik. Kantacuzenus, në pamundësi për të mposhtur Paleologin, me 1345, u kërkoi ndihmë ushtarake turqve.⁽⁸⁾ Madje, ai lidhi miqësi me osmanët, duke e martuar vajzën e tij me sulltan Orhanin. Osmanët, për herë të parë në histori, u vendosën në Galipoli dhe në vitin 1361 sulltan Murati II pushtoi Adrianopojën në Trakën Lindore. Ata që sollën islamin në Gadishullin Ilirik gjatë viteve 1345-1361, gati pesë shekuj më vonë po shpërngulnin me qindra dhe mijëra shqiptarë myslimanë drejt Turqisë. “Zgjidhja përfundimtare” e Çamërisë erdhi në fund të Luftës së Dytë Botërore. Kjo është aq e dukshme, sa që hulumtimet historike janë tashmë gati të panevojshme. Në fund të fundit, vetë gjeneral Zerva krenohet për mizoritë e tij në gjenocidin ndaj shqiptarëve të Çamërisë. Në letrën që i shkruante mikut të tij, Jani Dani Popoviti, më 4 gusht 1953, ai thoshte: “Bëjua të qartë njerëzve se ne e kryem detyrën që na ishte ngarkuar për spastrimin nga atdheu ynë të çamëve myslimanë, të cilët qëndruan 500 vjet mbi qafë të helenizmit dhe ua bëmë të mundur malësorëve të zbresin në fusha”⁽⁹⁾. Mjafton të lexosh këtë letër për të krijuar një përshtypje shumë të qartë për fatin e shqiptarëve atje. Përpyekjet për “zgjidhjen përfundimtare” vazhduan edhe në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Kulmin e tyre këto përpjekje e patën gjatë kohës së Rankoviçit. Në bazë të hulumtimit sistematik të dy shërbimeve konsullare (sektorit të pasaportave) jugosllave dhe turke, dëshmohet se gjatë kësaj periudhe, 1951-1968, prej Jugosllavisë në Turqi janë shpërngulur 414500 shqiptarë.⁽¹⁰⁾

Për serbët, shfarosja e shqiptarëve asnjëherë nuk qe e mjaftueshme dhe për këtë ka një arsye shumë të fortë. Ndjenja e madhësisë serbe është e gatuar në kuzhinat e manastireve ortodokse që në mesjetë. Është e natyrshme që manastiret serbe (si pjesë përbërëse të saj) të kenë pasur një ndikim të madh nga manastiret e Perandorisë Bizantine. Në lidhje me këtë perandori, Volteri shprehet: “... ajo ishte një tufë historish të turpshme, të cilat nuk përmbajnë asgjë tjetër veçse klithma dhe mrekulli. Ato janë

⁸ Encyclopedia Britannica.

⁹ S.Muselimi. “Istoriko Peripato ana ti Thesprotia”, Janinë, 1974.

¹⁰ Ndrìçim Iseni. Marrëveshja turko-greke-jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve.

poshtërimi i shpirtit njerëzor, poshtërimi i rruzullit tokësor". Prej aty, kjo ndjenjë, në mënyrë të pandërprerë është përhapur në këngët dhe legendat e folklorit serb për shekuj me radhë. Këtu ia vlen të silltet ndërmend kënga rrënoqethëse: "*Motra e kapiten Lekës*",⁽¹¹⁾ sipas së cilës, Krajleviç Marko, ndonëse ishte mysafir në pallatin e Lekës hakmerret ndaj Rosandës, e cila nuk pranon të bëhet gruaja e tij. Krajleviç Marko ia nxjerr asaj sytë, pastaj ia copëton trupin me thikë. Me kalimin e kohës, kjo përzierje ndjesish midis dëshirës për persekutim, xhelozisë dhe mbivlerësimit të vetvetes, kaploi edhe mendjet e akademikëve serbë, të cilët i kushtuan këtij këmdvështrimi me mijëra faqe librash dhe vite të tëra pune. Gjithashtu, rruga e spastrimit etnik ndaj shqiptarëve iu është hapur serbëve nga Rusia, që kur konti Neselrod i shkruante mbretit serb Karagjorgjeviç, më 23 nëntor të vitit 1852. Ndër të tjera, në atë letër shkruhej: "*Të gjitha të drejtat që i gëzon Serbia janë të paguara me gjakun rus, ngaqë ato janë fituar nga marrëveshjet e arritura pas luftrave gjakatare të udhëhequra nga Rusia*". Rrjedhimisht, serbët sa herë që zihen ngushtë dhe sa herë që përpiqen të çlirohen nga makthi i urrejtjes, nënvetëdija dhe instinktet e tyre i drejtojnë ata drejt shqiptarëve. Koha tregoi se ata do t'u ktheheshin shqiptarëve përsëri, si asnjëherë më parë në historinë e përgjakshme midis shqiptarëve dhe serbëve.

Gjatë drekës, më 11 mars 1981, në mensën e Universitetit të Prishtinës një student gjeti një mizë në pjatën e supës. Do mjaftonte vetëm kaq për të ndezur flakët e zemërimit dhe brenda pak orësh do të shpërthenin ato që njihen si protestat e pranverës së 81-it. Pakkush do ta besonte se ai çast do të shënonte fillimin e fundit të Jugosllavisë sipas modelit të Titos. Gjashtë vjet më vonë, më 24 prill 1987, një anëtar i thjeshët i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Serbisë në Fushë - Kosovë "*do të mbronte të drejtat e pamohueshme të serbëve*" në një fjalim që do ta shndërronte atë brenda ditës në një hero kombëtar. Millosheviç, në fakt po mbronte tezat folklorike të Anne Yellen, e cila në librin: "*The Orthodox Yugoslavia*" thotë: "*...në betejën e Kosovës u luftua për të drejtat e shpirtit serb dhe se kjo betejë fillon në 1389-n dhe mbaron në 1999-n*".⁽¹²⁾

¹¹ Serbian Anthology.

¹² Sherif Delvina. The truth on Kosova. F. 119.

Në pranverën e vitit 1992, Serbia filloi luftën për shtrirjen e territorit të saj në Bosnjë. Thirrje të përsëritura serbo - nacionaliste tashmë u përqendruan në kërcënimin islam. Përfaqësuesi tipik i këtyre thirrjeve ishte Radovan Karaxhiç me tezat e tij të rrezikut demografik (numri i lartë i lindjeve të myslimanët e Bosnjës), i cili u shpreh më vonë në të njëjtën mënyrë për myslimanët e Kosovës. Gjithashtu, mediat serbe shpesh aluduan për *“rrezikun e gjysmë hënës islame”*, e cila mund të shtrihej nga Bosnja përmes Sanxhakut deri në Kosovë.

Serbët, në këtë mënyrë po bënë përpjekje për ta shfajësuar veten përpara Europës si mbrojtës të qytetërimit dhe të vlerave të saj, vite para se të fillonin shfarosjen kombëtare dhe fetare të shqiptarëve në Kosovë. Në këtë mënyrë po fillonin të viheshin në jetë planet ogurzeza të përpiluara që në gjysmën e dytë të shekullit XIX nga akademikët serbë, si Ivo Andriç Stefan Moleviç, Vasa Çubrilloviç etj. Në fillim të viteve '90, konfliktet për pavarësi brenda Jugosllavisë u cilësuan si luftra kombëtare, paçka se në fakt ato sikurse edhe në Kosovë e kudo gjetkë ishin në të vërtetë sa kombëtare po aq edhe fetare. Le të mos harrojmë fjalimin inagurues të presidentit kroat, Franjo Tuxhman, i cili e krahasonte ardhjen e tij si President i Kroacisë me ardhjen e Mesajës në Jerusalem. Ndryshe nga pjesa tjetër e ish-Jugosllavisë, në Kosovë, lufta bëhej midis serbëve ortodoksë dhe mbi 90% të popullsisë së Kosovës, shumica dërrmuese e tyre myslimanë.

Për të gjithë shqiptarët, Lufta e Kosovës, do të mbetet gjithmonë një luftë për çlirimin e një pjese të kombit tonë nga pushtuesit e mirëfilltë serbë. Për kokat e nxehta serbe ishte thjeshtë një marrëzi e nxitur nga urrejtja dhe dritëshkurtësia e tyre, pa qenë në gjendje të dallojnë se ku mbaron urrejtja ndaj myslimanëve dhe ku fillon ajo ndaj shqiptarëve.

Në fund të fundit, ishte NATO ajo që dëboi ushtrinë serbe nga Kosova. Me përjashtim të Turqisë, të gjitha shtetet pjesëmarrëse në luftë, nën mburojën e NATO-s ishin kristiane. Ky fakt është shuplaka më e rëndë në fytyrën e serbëve, që nga koha kur e shpallën veten *“mbrojtës të qytetërimit European”* e deri më sot.